

**MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE**

Bashkia Kamëz zgjeron bashkëpunimin me kompani serioze italiane, siç është "Pesaresi Giuseppe S.p.A. Costruzioni"



FAQE 4

**INVESTIME**

Rruga "Halim Xhelo", një tjetër investim i rëndësishëm që u vjen në ndihmë qytetarëve të Paskuqanit



FAQE 6

**SHËRBI ME**

Bashkëpunimi i Bashkisë me BKT, shtohet numri i pemëve të mbjella në qytetin e Kamzës



FAQE 8

**TAKIMI ME SIPËRMARRËS SLLOVAKË**

Kompania "Laser Media" merr përsipër ndriçimin e të gjitha lagjeve të qytetit



FAQE 4



# Gazetë e Bashkisë Kamëz

# KAMZA

E përdyjavshme  
 Nr. 213 prill 2018  
 Çmimi 20 lekë  
 drmediakamez@gmail.com  
 www.kamza.gov.al

## KAMZA – 22 VJET BASHKI

FAQE 2-3

**26 binjakëzime të Bashkisë me qytete të ndryshme, suksese dhe përfitime për Kamzën dhe banorët e saj**

Faqe 5

**Kryebashkiaku Xhelal Mziu, takim me përfaqësues të kompanisë italiane "L'Operosa"**

Faqe 4

**Investimet e Bashkisë Kamëz në infrastrukturë, sukses i mirëpërdorimit të të ardhurave**

Faqe 7

**Kaldaja te kopshti "Kamza e Re", bashkëpunim i ngushtë Bashkisë Kamëz me pedagogët e Universitetit Bujqësor**

Faqe 8



**Kryebashkiaku Mziu, i pranishëm në Konferencën Rajonale mbi Përfshirjen Sociale dhe Riintegrimin në Nivel Lokal**

FAQE 4



**NË BRENDËSI**

**Bashkia Kamëz, pjesë e trajnimit "Politikat e Bashkimit Evropian në nivel vendor"**

FAQE 5

**Në projektet e Bashkisë Kamëz për 2018-n, edhe rikonstruksioni i shkollës "Tahir Sinani" në Kodër të Kuqe, Babrru**

FAQE 6

**Mbyllet sezoni i mbjelljeve në Bashkinë Kamëz me një numër prej 121 mijë e 423 pemësh**

FAQE 8

**Takim ndërgjegjësues për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike**

FAQE 5

**Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe fondacioni "Hanns Siedel", trajnim për taksën e ndërtesës në Bashkinë Kamëz**

FAQE 6



# KAMZA – 22 VJET BASHKI

## Kryebashkiaku Xhelal Mziu mbledh ish-kryebashkiakët, shpallen “Qytetar Nderi”

Më 30 prill 2018, Bashkia Kamzë mbushi 22 vjeç. Përmes një ceremonie festive e cila nisi që më 29 prill me koncertin e shkollave të Pallati i Kulturës, Kampionatin e Karatesë, paradën e festivalistëve dhe Festivalin Multikulturore, ajo ka kulmuar më 30 prill me ceremoninë zyrtare, ku të ftuar ishin, përpos shumë qytetarëve të nderuar dhe kontribuues ndër vite në Kamzë, edhe prefektja e Tiranës znj. Suzana Jahollari dhe ish-drejtuessit vendorë në Kamzë, Pëllumb Lepi, Ruzhdi Keçi, Fran Gjini, Agim Cani, të cilët u shpallën “Qytetarë Nderi” të Kamzës, si dhe kryebashkiakët në detyrë, kolegë të kryebashkiakut Xhelal Mziu, përfaqësues të së majtës dhe të djathtës në pushtetin vendor. Në këtë ceremoni morën titullin “Mirënjohja e Qytetit” Rexhep Uka ish-ministër Bujqësie dhe zv.kryeministër, Shaban Uka volejbollist, Sejdin Çela kampion në 10-garësh në atletikë, artistët e skenës: Ema Qazimi dhe Besim Zekthi dhe dhjetëra personalitete të tjera në mjaft fusha që kanë dhënë një kontribut të çmuar për Kamzën ndër vite. Ceremonia nisi që herët në mëngjes me përfaqësues të Parlamentit Rinor, të cilët ishin të pranishëm në sallën e Këshillit Bashkiak në një veprimtari me këtë rast dhe ka vijuar më pas me hapjen e ceremonisë zyrtare nga kryetari Xhelal Mziu, më pas e shoqëruar me lëvizjen e bandës frymore në qytet si dhe lëvizjen prezantuese të pedonalja për të vijuar më pas me finalizimin e ceremonisë zyrtare në Pallatin e Kulturës. Sikurse dhe më parë në hapjen e ceremonisë të shkallët e Pallatit të Kulturës dhe në ceremoninë zyrtare brenda mjedisëve të pallatit, kryebashkiaku Mziu bëri një prezantim të shkurtër të asaj çfarë ka ndodhur në Kamzë gjatë viteve post-tranzicion. Duke falënderuar paraardhësit e tij për punën e bërë në krye të Bashkisë dhe drejtimit e punëve të qytetit, zoti Mziu pohoi se pavarësisht asaj që bëri më parë zhvillimet në qytet morën vrull dhe sot qyteti ka ndryshuar rrënjësisht.

Në fjalën e tij kryebashkiaku Xhelal Mziu tha: “Ju falënderoj për zemërsisht për praninë në festën e qytetit tonë, Kamza! Dua të falënderoj prefektin e Tiranës, ish-kolegët e mi kryebashkiakë të qytetit të Kamzës, kryetarët e këshillave bashkiakë, përfaqësues të pushtetit qendror, këshilltarë të sotëm e të viteve të kaluara dhe të gjithë ata që për shumë arsye nuk patën mundësi për të qenë të pranishëm këtu! Ndërkohë, gjej rastin për t’u kërkuar ndjesë të gjithë atyre, të cilët për arsye jo të dëshirës nuk patën mundësi për t’i ftuar apo janë harruar nga stafi i Bashkisë!”

Mes të tjerave, në fjalën e tij z. Mziu pohoi: “Kamza ka pasur edhe simbolikën e saj, ka pasur edhe Institutin e Lartë Bujqësor të Kamzës ka pasur edhe minatorët e Valiasit, të cilët u bënë promotorë të ndryshimit të sistemit në vitet ‘90. Unë ndihem shumë krenar dhe i gëzuar që kam drejtuar Bashkinë e Kamzës, si një qytetar i viteve ‘90. Besoj që Kamza ka pozicionin më të mirë gjeografik në Shqipëri dhe pozicioni i saj, mikpritja e këtyre qytetarëve të mrekullueshëm të Kamzës, të Valiasit, të Laknasit dhe të Babroit bëri që të gërshetohet jo vetëm pozicioni gjeografik, por edhe mikpritja për



ta kthyer nga një zonë bujqësore e rurale në një qytet, madje në qytetin më të ri të Shqipërisë, pse jo, edhe më gjerë dhe sot Kamza nuk është më si dje, jo vetëm për shkak të numrit të popullsisë, nga e cila është e gjashta në Shqipëri, por edhe për shkak të zhvillimit të vrullshëm të saj. Dhe ky zhvillim i vrullshëm i qytetit ka vetëm një autor: qytetarët e saj. Qytetarët e Kamzës janë mbi mesataren e Shqipërisë. Janë njerëz, të

kontribuar në infrastrukturën e munguar të qytetit, veçanërisht qeverinë “Berisha”, i cili hodhi themelet e vërteta të një qyteti, me urbanizmin e saj, me infrastrukturën arsimore, shëndetësore, rrugore, të ujësjellësit dhe të kanalizimeve. Kamza nuk është më si dje, falë këtyre aktorëve. Ka pasur edhe të tjerë kontribuues. Dua të përmend Co-Planin, i cili ka hedhur kornizën e ngritjes së një qyteti. Dua të



cilët përmes vuajtjes, ambicies, imigrimit të brendshëm e të jashtëm bënë që të harrohej Kamza bujqësore e të kthehej në qytet?”

“Sot Kamza ka një diversitet të jashtëzakonshëm kulture, zhvillimi, jo vetëm nga krahinat nga kanë ardhur, por edhe për shkak të punësimit të tyre që ata kanë pasur në vendet e Bashkimit Evropian. Sot në çdo lagje që të shkosh, mahnitësh nga ndërtimet të cilat janë bërë me djersën e tyre, duke sfiduar të kaluarën e tyre. Ju jeni dëshmitarë të viteve ‘95-96, kur rrjetet më të fuqishme, “Euronews” etj., jepnin ndërtimet informate me plasmas, me dërrasa dhe ky ndryshim ka ndodhur vetëm për këtë arsye, vetëm për shkak të qytetarëve. Por nuk mjafton për ta bërë një qytet kontributi i qytetarëve. Duhet bërë edhe një kombinim i qeverisjes vendore, ku unë duhet të falënderoj z. Lepi, z. Keçi, z. Gjini në mungesë, z. Cani, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në krijimin e këtij qyteti. Nuk mund të lë pa përmendur qeveritë shqiptare, të cilat kanë

përmend donatorë të tjerë vendas, por nuk mund të lë pa përmendur edhe kontributin që kanë dhënë donatorët më të mëdhenj sot në botë, siç është Banka Botërore, Komisioni Evropian, USAID-i, OSBE etj., të cilët kanë kontribuar financiarisht, por edhe në konsulencë, për ta ndryshuar këtë qytet, për ta sjellë në standardet që ai duhet të ketë. Ndërkohë, ka edhe mjaft aktorë të tjerë, të cilët kanë kontribuar, por unë nuk dua të bëhem i bezdisshëm, por sot Kamza është më ndryshe”, - tha z. Mziu. Më tej ai theksoi: “Sot Kamza ka arsim, infrastrukturë arsimore të standardeve të Bashkimit Evropian. Sot Kamza ka infrastrukturë rrugore jo vetëm të pakrahasueshme me të kaluarën, por konkurruese edhe me qytetet e tjera historike. Sot Kamza ka një pallat kulture, të cilin e kanë zili edhe qytetet e tjera mijëvjeçare të Shqipërisë. Sot Kamza ka sportin që është jo vetëm në Superligë, por po i jep edhe një dimension tjetër sportit dhe imazhit të qytetit. Ajo çfarë është e rëndësishme për mua dhe për secilin është

imazhi i qytetit. Sot qyteti i Kamzës është një imazh pozitiv jo vetëm për Kamzën, por edhe më gjerë. Mjafton po të shkosh te një punëdhënësi, të gjithë kërkojnë për të pasur njerëz nga Kamza, sepse janë më vitalë, janë më të rinj, janë më energjikë dhe janë më të besueshëm. Dhe jo më kot sot është kthyer në një treg punësimi, të ardhjes së kompanive të huaja, ndaj dhe sot Kamza ka ndryshuar”. “Unë edhe një herë gjej rastin për t’ju falënderuar për zemërsisht për pjesëmarrjen dhe për të përgëzuar, jo vetëm në emrin tim, por edhe më gjerë, qytetarët e Tiranës të cilët hapën dyert e tyre në vitin ‘90, për të falënderuar për kontributin që kanë dhënë qytetarët e tjerë të cilët kanë ardhur nga vendet e tyre, sepse me kontributin e tyre sot ka marrë këto dimensione qyteti i Kamzës dhe inkurajoj çdo qytetar të Kamzës për të punuar edhe më shumë për të vendosur edhe një tullë më tej në imazhin pozitiv të qytetit. Edhe një herë ju falënderoj dhe ju uroj festë të mbarë!”, - përfundoi fjalën e tij kryebashkiaku Xhelal Mziu.

Në fjalën e saj prefektja Suzana Jahollari theksoi: “Kamza është në një ditë të veçantë, një ditë përvjetori. 22 vite nuk janë shumë, por nuk janë as pak për një qytet të ri siç është edhe Kamza. Pasi dëgjova gjithë ato fjalë të mira dhe duke parë zhvillimin e Kamzës në vite, janë të tepërta fjalët e mia për çfarë ndryshimi dhe çfarë zhvillimi ka pësuar Kamza dhe në të vërtetë ka ndryshuar shumë. Ka zhvilluar shumë anë dhe aspekte të jetës së saj. Ai mesazh që japim në sot, edhe unë nëpërmjet institucionit të Prefektit që përfaqësoj, është që të gjithë së bashku të punojmë shumë, të përpiqemi shumë që të rritim cilësinë e jetës sonë. Dhe institucioni i Prefektit e ka për detyrë për të gjithë, sepse është për të gjithë qarkun, për të gjitha bashkitë, për të gjitha institucionet e pushtetit vendor; t’i organizojë, t’i kontrollojë, t’i monitorojë dhe të bashkëveprojë, me qëllimin e vetëm për të siguruar zbatimin e programit të qeverisë e për të rritur cilësinë e jetës, sepse gjithçka që flasim ne, që bëjmë ne, duhet të konvergojë në një qëllim: të rritim cilësinë e jetës. Dhe unë ju uroj shumë në këtë ditë përvjetori dhe e përgëzoj kryetarin e Bashkisë dhe e uroj për këto suksese që ai ka realizuar në drejtimin dhe qeverisjen e Bashkisë së Kamzës”.

Në këtë takim folën dhe ish-kryetarët e Bashkisë, të pranishëm në këtë takim. Ish-kryetari i Bashkisë (1996-2000) z. Ruzhdi Keçi tha: “Unë ndihem edhe i nderuar, por edhe i emocionuar që po flas para jush. Erdha kryetar Bashkie në moshën më vitale, 43 vjeç, dhe sot jam këtu, në epilogun e jetës, në prag pensioni, dhe shoh që kanë rrjedhur goxha vite. Natyrisht, si kryetar i parë, të paktën formalisht si Bashki, pata edhe nderin të drejtoja këtu, por edhe përgjegjësinë e madhe, aq më tepër për kohën në të cilën unë isha kryetar. Dhe, kur shoh sot Kamzën, në njëfarë mënyre, dua të jem i sinqertë, them që paskam ndenjur kot, s’paskam bërë asgjë kur kam qenë katër vjet këtu. Dhe, sot, natyrisht, më bëhet zemra mal kur shoh të gjitha ndryshimet që ka Kamza dhe renditet në bashkitë më të rëndësishme të Shqipërisë



# FESTA E KAMZËS



dhe, në retrospektivë, gjithmonë i kthehem asaj që ka mbetur në memorie, asaj Kamze që unë gjeta në '96-n, që thashë edhe një herë nuk ka krahasim me sot". Zoti Keçi falënderoi kryetarin e Bashkisë, jo vetëm për punën që ka bërë, por edhe për këtë 22-vjetor, për këtë nismë që po merr Bashkia, për ta kthyer në një festë lokale, për t'u festuar çdo vit në përvjetorët e ardhshëm. "Natyrisht, kemi qejf që të jemi sa herë që të ketë përvjetor. Po qe se Zoti e ka thënë, kam qejf që të jem edhe në 122-vjetorin e kësaj Bashkie",

pas reformës agrare, Kamza u bë një nga ndërmarrjet bujqësore më të mëdha në Shqipëri. Kjo ndërmarrje është njohur me emrin ndërmarrja bujqësore "Ylli i kuq" dhe shërbente si furnizuesja kryesore e kryeqytetit me prodhime të ndryshme bujqësore dhe blegtorale. Kjo periudhë vazhdoi rreth 45 vjet. Pas vendosjes së demokracisë në Shqipëri, edhe Kamza pësoi ndryshime shumë të thella demokratike. Në vitin 1991, në Kamëz vendoset Komiteti i parë Pluralist, ku pushteti vendor drejtohej



- tha z. Keçi. Edhe ish-kryebashkiaku Agim Cani vlerësoi punën e bërë nga stafi i tij në kohën që drejtonte Bashkinë duke i cilësuar profesionistë të zotë sikurse evidentoi dhe ndryshimet e ndodhura nën mandatin e Xhelal Mziut prej vitit 2007. Sipas z. Cani, Kamza ka ndryshuar rrënjësisht dhe kjo është meritë e liderit dhe administratës së Bashkisë. Të njëjtin vlerësim bëri dhe ish-kryetari i komunës, z. Pëllumb Lepi.

me balancë politike të të dyja forcave kryesore të atëhershme. Në vitin 1992, për herë të parë, si në gjithë Shqipërinë, u zhvilluan zgjedhjet e para demokratike, si për pushtetin qendror dhe atë lokal. Në atë kohë në Kamëz regjistroheshin vetëm 6000 banorë. Më 30 prill 1996, me një vendim të Këshillit të Ministrave, Kamza ndryshon emërtimin nga komunë në bashki. Ky moment shënon edhe krijimin e institucionit Bashkia Kamëz.

## Historiku dhe zhvillimi i qytetit të Kamzës

Kamza ka qenë një fushë, e cila në pjesën më të madhe të kohës ishte e përmytur nga ujërat, si rrjedhojë ka qenë një zonë jo shumë e populluar. Para disa shekujsh, tokat e Kamzës kishin kryeqendër Prezën. Rreth viteve 1250 të erës sonë, ngulimet në zonën e Kamzës ishin rreth brigjeve të lumenjve të Tiranës e Tërkuzës, periudhë kjo në të cilën zotër të këtyre tokave ishin Tanush e Karl Topia. Në vitin 1431 del në dritë emri Kamëz. Dëshmitë e arritura deri në ditët tona pohojnë se në tokat e Kamzës kishte shumë ullinj të egër. Rreth trungut mbinin filiza që thirreshin kamza ulliri. Për këtë arsye tokat midis lumit të Tiranës dhe Tërkuzës u quajtën Kamza. Në vitin 1700 filluan të shtoheshin shtëpitë me fshatarë që zbrisnin nga malësitë. Pas Çlirimit, Kamza u formua në fillim si një ekonomi shtetërore me karakter kooperativist dhe

## Transformimi rrënjësor i Kamzës nga 2007

Bashkia sot ka mbi 140 mijë banorë. Kamza ka pësuar ndryshime rrënjësore e ndoshta do duhen faqe të tëra për të numëruar arritjet, ose projektet e realizuara. Krahasuar me vitin 2007, realiteti është krejt ndryshe. Kamza është ndër qytetet e para që miratoi planin urbanistik, qyteti i vetëm me sistem të plotë adresash ku janë emërtuar mbi 505 rrugë dhe është gati për implementimin e ZIP-KOD-it. Janë asfaltuar me qindra e qindra km rrugë, janë shtrirë me qindra rrjet të ujësjellës-kanalizimeve duke përmirësuar ndjeshëm furnizimin me ujë të pijshëm. U mundësua mbyllja e fazës së parë të projektit të ujësjellës-kanalizimeve nga banka gjermane KfW, dhe së shpejti fillon implementimi i fazave të tjera. Mbi 70% e popullsisë kanë rrjet të ri ujësjellësi dhe furnizim me ujë. Është mundësuar edhe shtrirja e rrjetit të

## Personalitet që u vlerësuan me titullin "Qytetar Nderi"

1. Ruzhdi Keçi
2. Pëllumb Lepi
3. Fran Gjini
4. Agim Cani

## Personalitetet që u vlerësuan me "Certifikatën e Mirënjohjes"

1. Rexhep Uka
2. Shaban Uka
3. Besnik Aliaj
4. Dritan Shutina
5. Besim Zekthi
6. Ema Qazimi
7. Kastriot Shtylla
8. Tomas Tuholli (pas vdekjes)
9. Qazim Muja
10. Rexhep Muka
11. Fejzulla Leçka
12. Sejdin Çela
13. Nesret Zylfi
14. Petrit Xhaja
15. Xhemal Burreli
16. Dilaver Shaho
17. Albert Shtylla
18. Astrit Çuçka
19. Gëzim Shima
20. Zenel Gjokrosa

Prill 2018  
GAZETA KAMZA



me mbi 10 mijë veta ku një ndihmë ka dhënë sektori fason. Të ardhurat e Bashkisë janë mbi 10-fishuar krahasuar me vite më parë. Kamza sot është një qytet i pastër me makineri pastrimi bashkëkohore dhe kontejnerë të standardeve evropiane. Është mundësuar shtrirja e linjës së telefonisë fikse dhe internetit në gjithë territorin e Kamzës. Të tjera projekte janë në zbatim jo vetëm ndërtimin e qindra km rrugë dhe KUZ, por dhe qendra e qytetit të Kamzës bashkë me pedonalen, rehabilitimi i Qendrës së Babrrusë etj.

## Festa e Kamzës nisi me anëtarët e Parlamentit Rinor

Në sallën e Këshillit Bashkiak u zhvillua një seancë e Parlamentit Rinor, anëtarë të të cilit ishin nxënësit më të mirë të shkollave 9-vjeçare dhe gjimnazeve të Kamzës. Kjo veprimtari u zhvillua në kuadrin e festimeve për 22-vjetorin e shpalljes së Kamzës Bashki. Morën pjesë në këtë seancë kryetari i Bashkisë, z. Xhelal Mziu; kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Bilbil Bajraktari; sekretari i Këshillit Bashkiak, z. Sokol Ndreu dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Sportit, z. Gani Berisha.

Fillimisht, kryetari i Këshillit, z. Bajraktari, falënderoi nxënësit për pjesëmarrjen. Gjithashtu, falënderoi kryebashkiakun Mziu për këtë nismë, si dhe Zyrën Arsimore Kamëz. Në vijim të fjalës së tij, z. Bajraktari bëri një prezantim të mënyrës së zgjedhjes së Këshillit Bashkiak dhe të funksioneve të tij.



furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike 20 kv mbi 70% të popullsisë. Janë ndërtuar 18 objekte shkollore (shkolla dhe kopshte) me standarde evropiane. Bashkia ka ndërtuar Pallatin modern të Kulturës për të rinjtë dhe të gjithë qytetarët një nga më të mirët në vend. U ndërtua stadiumi i qytetit si dhe palestra moderne e basketbollit në Bathore. Është ngritur qendren e shërbimeve ndaj qytetarëve, One Stop Shop, më e mira në Shqipëri, e vlerësuar nga ndërkombëtarët si praktika më e mirë e qeverisjes vendore. Është 4-fishuar numri i bizneseve falë taksave të ulëta dhe klimës së mirë të krijuar, gjë që ka mundësuar edhe punësimin e mijëra qytetarëve. Bashkia Kamëz ka pasur një paketë fiskale konkurruese dhe stimuluese për zhvillimin e biznesit gjë që ka çuar në rritjen e numrit të të punësuarve

Ndërkaq, në fjalën e tij, kreu i Bashkisë, z. Xhelal Mziu, i falënderoi për zemërsisht nxënësit pjesëmarrës në Parlamentin Rinor të Kamzës. Ai i uroi ata me rastin e festës së Kamzës, themelimit të saj si Bashki. Ai theksoi se nuk është hera e parë që organizohet një "parlament" i tillë, pasi kjo është një traditë tashmë në Bashkinë e Kamzës. "Salla e Këshillit Bashkiak sot është rinuar dhe zbukuruar si asnjëherë tjetër. Do të kisha dëshirë që Këshilli Bashkiak të ketë në të ardhmen të rinj si ju, ndaj dhe unë ju inkurajoj që të përparoni në shkollë, në studimet e larta, të jeni të aftë në fusha të ndryshme, që të rritim imazhin e qytetit tonë", - u shpreh ndër të tjera z. Mziu. Ai i uroi edhe maturantët që të arrijnë rezultate të shkëlqyera në provime, që të jenë promotorë të qytetit, pasi Kamza ka nevojë për të gjithë.



## Kryebashkiaku Mziu, i pranishëm në Konferencën Rajonale mbi Përfshirjen Sociale dhe Riintegrimin në Nivel Lokal

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, mori pjesë në Konferencën Rajonale mbi Përfshirjen Sociale dhe Riintegrimin në Nivel Lokal, e cila zhvillohet në Qendrën e Kongreseve, Bërdo, Slloveni në datat 17 dhe 18 prill 2018.

Kryebashkiaku Mziu ishte pjesë e delegacionit të Shoqatës e Bashkive, e cila ka statusin e themeluesit dhe anëtarit të NALAS-it (Rrjeti i Asociacioneve të Komunave në Evropën Juglindore). Pikërisht në Bërdo të Sllovenisë po zhvillohen punimet e Asamblesë të Përgjithshme të NALAS-it.

Në Asamblesë të Përgjithshme të NALAS-it morën pjesë delegacionet e 14 Shoqatave të Bashkive të 12 shteteve të Evropës Juglindore. Nga SHBSH mori pjesë z. Xhelal Mziu, kryetar i Bashkisë Kamëz dhe anëtar i kryesisë së SHBSH; z. Agron Kapllanaj zv.kryetar i SHBSH



dhe kryetar i Bashkisë Mallakastër dhe z. Agron Haxhimali drejtor ekzekutiv i SHBSH.

Në fillim të konferencës u prezantua axhenda e saj nga z. Mico Micic, president i NALAS-it.

Konferenca vijoi me çështje të tilla siç janë përfshirja sociale, sfidat e axhendës 2030 në panelin e diskutimit “Nga teoria



në praktikë”; partneritetet si mjete mes qeverisë lokale dhe organizatave të shoqërisë civile në zbatimin efektiv të axhendës 2030 dhe SDGs me fokus të veçantë në përfshirjen sociale. Gjithashtu pati reflektime të panelit të diskutimeve; të mësojmë nga eksperiencat, nëpërmjet metodës “World Café” që është një format i thjeshtë, efektiv dhe fleksibël për

të dialoguar me grupe të mëdha. Ideja kryesore ishte që grupet e pjesëmarrësve të diskutonin 4 aspekte të temës kryesore të konferencës. Në fund të punimeve dyditore të konferencës u bë prezantimi i rezultateve dhe vërejtjet përmbyllëse.

Në ditën e parë të Konferencës Rajonale mbi Përfshirjen Sociale dhe Riintegrimin në Nivel Lokal u diskutua gjithashtu për Strategjinë

e Zgjerimit të Bashkimit Evropian si dhe Axhenda e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe qëllimet e saj në shtetet e Evropës Juglindore.

Ndërsa në ditën e dytë vijuan punimet e takimit më të lartë të NALAS-it, që është edhe takim vjetor, ku u diskutua për raportet vjetore të punës së kësaj organizate rajonale të pushtetit lokal.

## Bashkia Kamëz zgjeron aktivitetin e bashkëpunimit me kompani serioze italiane, siç është “Pesaresi Giuseppe S. p. A. Costruzioni”

Në kuadrin e bashkëpunimit të vazhdueshëm që Bashkia Kamëz ka në kuadrin e partneritetit të gjerë me sipërmarrje serioze të kompanive të huaja, kryebashkiaku



Xhelal Mziu priti në një takim pune një kompani italiane të specializuar në fushën e ndërtimit të rrugëve, si dhe fusha të tjera investuese për të mundësuar zgjerimin e aktivitetit në territorin e Kamzës. Kjo marrëdhënie

e ngushtë e ka objektin e saj në terrenin e favorshëm që ka krijuar institucioni i Bashkisë Kamëz në lehtësirat, për shkak të politikave fiskale dhe mjaft favorizuese në zbatimin e një pakete fiskale shumë të favorshme.

Kryebashkiaku Mziu i garantoj të pranishmit në këtë takim se do të gjejnë të gjitha elementet e favorshme për të realizuar investimet në infrastrukturë e kudo. “Duke vlerësuar bashkëpunimin e dyanshëm mbetëm me mendimin se shumë shpejt krahas kompanisë suaj edhe kompani të tjera serioze do të transferojnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Kamëz jo vetëm për shkak të pozicionit gjeografik mjaft favorizues, por edhe për shkak të politikave lehtësuese të taksave në këtë Bashki”, - u shpreh ndër të tjera z. Mziu.

“Pesaresi Giuseppe S.p.A. Costruzioni” është një nga kompanitë më të suksesshme në sektorin e ndërtimit të rrugëve nëpërmjet teknologjisë moderne.

Kjo kompani kualifikohet si një nga ealitetet më interesante të punës në Itali. Arsytet për këtë sukses mund të identifikohen në disa faktorë me rëndësi të madhe siç është evolucioni teknologjik dhe intuita e evolucionit të tregut.

## Kryebashkiaku Xhelal Mziu, takim me përfaqësues të kompanisë italiane “L’Operosa”

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, pati një takim edhe me përfaqësues të kompanisë italiane “L’Operosa”. Në këtë takim kryebashkiaku Mziu i siguroi të pranishmit për lehtësirat në lidhje me terrenin e favorshëm për transferimin e një pjese të biznesit të kësaj kompanie në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillimin e qytetit. Ai theksoi se pozicioni gjeografik si dhe paketa fiskale e Bashkisë janë faktorë të cilët e bëjnë të mundur zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të kompanisë italiane me një rrjet shërbimesh të gjera dhe të përshtatshme për territorin e qytetit të Kamzës. Një tjetër faktor që e karakterizon Kamzën, në dallim nga të gjitha qytetet e tjera të Shqipërisë, është sepse ajo ka një moshë mesatare më të ulët sesa mesatarja kombëtare, gjë që favorizon gjetjen e burimeve njerëzore në drejtim të punësimit profesional. Në përfundim të fjalës së tij, z. Mziu u tregoi të pranishmëve se nga zhvillimi i fashoneve janë punësuar rreth 15 mijë të rinj dhe të reja. Në këtë kontekst do të thotë se Kamza zotëron burime të pashtershme profesionalizmi. Kjo e bën Kamzën më tërheqëse dhe bashkëpunuese me të gjithë komunitetin e biznesit në vend, por edhe një terren të pëlqyeshëm për biznesin përtej kufijve të Shqipërisë.

“L’Operosa” është një kompani shërbimi që funksionon



prej më shumë se 50 vjetësh. Përvoja, profesionalizmi i fituar dhe aftësia për t’u përshtatur me kërkesat në rritje të një tregu gjithnjë e në ndryshim, janë pikat e forta të një kompanie, e cila operon me sukses në objekte të tilla, si: shkolla, spitale, shtëpi të moshuarish, qendra drejtuese dhe infrastruktura të mëdha kulturore, kompani industriale dhe prodhuese. Kompania “L’Operosa” siguron cilësi dhe standarde të larta për klientët privatë dhe publikë, në fusha të tilla, si: ofrimi dhe menaxhimi i shërbimeve të integruara; pastrimi civil dhe industrial, kanalizimet dhe higjiena në kujdesin shëndetësor, projektimi dhe menaxhimi i parkingjeve private dhe publike, menaxhimi i integruar i parkimit, planifikimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e zonave të gjelbra, dezinfektimi, grumbullimi dhe transporti i autorizuar i mbeturinave dhe mirëmbajtja e mjedisit.

## Takimi me sipërmarrësit sllovakë, kompania “Laser Media” merr përsipër ndriçimin e të gjitha lagjeve të qytetit



Në kuadër të bashkëpunimit me biznesin e huaj, kryebashkiaku Xhelal Mziu zhvilloi një takim me një grup sipërmarrësish të huaj, përfaqësues të kompanisë sllovakë “Laser Media”, e specializuar për ndriçimin e hapësirave publike nëpërmjet teknologjisë së llambave LED.

Në qendër të këtij takimi ishte ngritja e një fabrike në Kamëz, që do të shërbejë si një qendër prodhimi për gjithë Ballkanin.

Gjithashtu, kompania “Laser Media” do të marrë përsipër ndriçimin e të gjitha lagjeve të qytetit nëpërmjet teknologjisë më të re të ndriçimit. Teknologjia e re e ndriçimit publik COB LED është miqësore me mjedisin. Kjo teknologji përdor ndriçimin STREET LAMPS LD-50 që ndihmon në ndriçimin e hapësirës me fuqi shumë më të ulët. Kompania “Laser Media” ofron një sërë ndriçimesh LED, që përdorin teknologjinë më të fundit, e ndjekur nga kursimi i lartë i energjisë, jetëgjatësia e gjatë dhe kostoja minimale e mirëmbajtjes.

Llambat ndahen në tri kategori: llambat LED për ndriçimin e rrugëve, ndriçimin e zyrave dhe ndriçimin e parqeve industriale dhe ndërtesave. Llambat LED janë përdorur gjerësisht, ato janë të përshtatshme për ndriçimin e rrugëve, parqeve, parkingjeve, zonave të ndriçimit në natyrë, ndërtesave, ndërtesave të fabrikës, parqeve industriale etj.

# 26 binjakëzime të Bashkisë me qytete të ndryshme, suksese dhe përfitime për Kamzën dhe banorët e saj

Prill 2018  
GAZETA KAMZA

5



Bashkia Kamzë është konsideruar si histori suksesi për sa i përket binjakëzimit me qytete të Bashkimit Evropian, por edhe më gjerë. Bazuar në miqësi dhe në mirëbesim, binjakëzimi mund të jetë një burim për shkëmbimin e përvojave dhe pasurimin e përbashkët në shumë fusha. Për 26 binjakëzimet e saj me qytete të ndryshme Bashkia Kamzë është vlerësuar edhe në "Manualin e binjakëzimit", botim i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë.

Po në këtë botim thuhet se Bashkia e Kamzës është shndërruar në një nga partnerët më potencialë e aktivë në marrëdhëniet me qeverisjen qendrore e vendore, shoqërinë civile dhe organizmat ndërkombëtarë, duke fituar besimin e mbështetjen e tyre të plotë dhe duke bashkëpunuar me ta në projekte të rëndësishme zhvilluese.

Përgjatë gjashtë viteve të fundit në qeverisjen vendore të Kamzës, proceset e binjakëzimit me qytete të shteteve fqinje sidomos të atyre anëtare të Bashkimit Evropian përbëjnë një objektivi kyç, gjithashtu një instrument të rëndësishëm me rol dhe ndikim të madh në misionin e hapjes dhe të bashkëpunimeve

ndërkombëtare të bashkisë. Binjakëzimet kanë pasur një peshë të madhe në afrimin dhe integrimin në Evropë dhe në botë. Gjithashtu, prej tyre përfitohet më shumë dhe më lehtësisht nga programet për mbështetje teknike e financiare nga strukturat ndërkombëtare. Nëpërmjet binjakëzimeve, krahas shkëmbimeve të ndërsjella të dyanshme të administratave, shkëmbimeve kulturore, arsimore, sportive etj., përfitohen drejtpërdrejt projekte të përbashkëta nga Bashkimi Evropian.

Në këtë drejtim, është bërë një punë voluminoze nga Drejtoria e Koordinimit-Zhvillimit dhe Projekteve. Kamza ka qenë përfituese e shumë projekteve nga Komisioni Evropian dhe organizmat e tjerë po aq të rëndësishëm.

Më poshtë edhe lista e binjakëzimeve të Bashkisë Kamzë:

Macerata, Itali  
Jena, Gjermani  
Kemalpaşa, Turqi  
Skenderaj, Kosovë  
Çair, Maqedoni  
Knittelfeld, Austri  
Bruck an der Leitha, Austri  
Liberi, Itali  
Vecpiebalga, Letoni  
Riebiņi, Letoni  
Roccamonfina, Itali  
Presenzano, Itali  
San Nicola La Strada, Itali

Poëiat Dabrowski, Poloni  
Slovenka Darmoty, Slloveni  
Klos, Shqipëri  
Cesa, Itali  
Casapulla, Itali  
Castenaso, Itali  
Galëay, Irlandë  
Quindici, Itali  
La Plata, Argjentinë  
Dorohoi, Rumani  
Berkovitsa, Bullgari  
Kumluca, Turqi  
Alexandria, Greqi

## Bashkia Kamzë, pjesë e trajnimit "Politikat e Bashkimit Evropian në nivel vendor"

Për dy ditë me radhë është zhvilluar në Vorë trajnimi "Politikat e Bashkimit Evropian në nivel vendor" në kuadër të projektit "Bashkitë për në Evropë". Në këtë trajnim Bashkia Kamzë u përfaqësua nga koordinatorja e projektit, znj. Valentina Baja. Trajnimi ishte i ndarë në dy ditë. Ditën e parë pjesë e çështjeve kryesore të aktivitetit ishte njohja me objektivat e trajnimit dhe pritshmëritë e tij; sa e njohim Bashkimin Evropian; procesi i integritimit evropian dhe Shqipëria; roli dhe efektet e integritimit evropian në qeverisjen vendore; Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit – cilat janë kompetencat që i kalojnë pushtetit vendor; kompetencat e integritimit evropian në nivel vendor – perceptimet, sfidat, mitet dhe përfitimet.



Ndërkaq, ditën e dytë pjesë e trajnimit ishin standardet evropiane në fushën sociale dhe të punësimit; standardet evropiane në fushën e mjedisit dhe bujqësisë; standardet evropiane në mbrojtjen e të drejtave të njeriut; diskutime dhe simulime bazuar në shembuj konkret dhe në fund vlerësimi i trajnimit dhe konkluzionet.

Projekti "Bashkitë për në Evropë" është një nismë e Bashkimit të Evropian, e cila synon të rrisë kapacitetet e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri në kuadër të procesit të integritimit evropian të vendit, duke ngritur në secilën bashki një zyrë të BE-së që do të jetë edhe pika e referencës në çdo bashki, jo vetëm për punonjësit e administratave vendore, por edhe për të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit në nivel vendor.

Në procesin e funksionimit të Këndeve të BE-së, këta të fundit kthehen në bashkëpunëtorin më të ngushtë të projektit, duke pasur dy funksione brenda tyre:

-Forcimi i kapaciteteve të njësive të tyre të qeverisjes vendore në lidhje me funksionimin e tyre brenda standardeve evropiane si dhe

përthithja e fondeve evropiane mbi bazë projektesh.

-Të shërbejnë si pika kontakti për njësinë e tyre të qeverisjes vendore, por edhe për të gjithë shoqërinë në rajonin e tyre, në lidhje me informimin për Bashkimin Evropian.

Këndet e BE-së, me mbështetjen e projektit "Bashkitë për në Evropë", luajnë rolin e forcimit të kapaciteteve të njësive të tyre të qeverisjes vendore në lidhje me funksionimin e tyre brenda standardeve evropiane si dhe përthithja e fondeve evropiane mbi bazë projektesh. Këto kënde shërbejnë si pika kontakti për njësinë e tyre të qeverisjes vendore, por edhe për të gjithë shoqërinë në rajonin e tyre në lidhje me informimin për Bashkimin Evropian.

## Takim ndërgjegjësues për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike

Në sallën e Këshillit Bashkiak të Kamzës u zhvillua një takim ndërgjegjësues për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike. Në



këtë takim, që u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional ndërmjet pushtetit vendor dhe policisë, merrnin pjesë përfaqësues dhe drejtues të Bashkisë Kamzë, ndërlihdës me komunitetin, përfaqësues të Drejtorisë së Policisë së Tiranës dhe shefi i komisariatit nr. 5 të Kamzës, z. Sali Skurra. Nën kryetari i Bashkisë, z. Zaim Kupa, u shpreh se bashkëpunimi ndërmjet pushtetit vendor dhe policisë duhet të jetë i ngushtë, për të mos lejuar kultivimin e bimëve narkotike në territorin e Bashkisë Kamzë. Në këtë aspekt ai shprehu gatishmërinë

e institucionit të Bashkisë për të bashkëpunuar në të mirë të komunitetit. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Policisë së Tiranës u shpreh se ky është një prej takimeve që zhvillohen edhe në institucione të tjera. Duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë me specialistët e policisë që të mos ketë fare kanabis në territorin e Kamzës. Ndërkaq, shefi i komisariatit nr. 5 të policisë i falënderoi ndërlihdësit me komunitetin për kohën e rezervuar për këtë takim. Ai shprehur falënderimet e tij për kryetarin e Bashkisë, z. Xhelal Mziu, për strukturat e kësaj Bashkie për bashkëpunimin e frytshëm që kanë pasur. Z. Skurra u shpreh se bashkëpunimi duhet të jetë i përditshëm në të mirë të komunitetit, gjë që përbën edhe një detyrë ligjore. Gjatë takimit pati diskutime nga ana e ndërlihdësve me komunitetin, të cilët shprehën gatishmërinë e tyre për bashkëpunim. Gjithashtu, ata kërkuan edhe një gatishmëri më të madhe nga ana e inspektorëve të policisë në terren për sa u përket çështjeve apo ngjarjeve të ndryshme.

## Bashkia Kamzë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndaj dhunës në familje

Bashkia Kamzë ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për riaktivizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Kjo marrëveshje u nënshkrua gjatë takimit të zhvilluar në sallën e Këshillit midis përfaqësuesit të Bashkisë Kamzë, përfaqësuesit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamzë, përfaqësueses së Qendrës Shëndetësore Kamzë, përfaqësueses së Zyrës Rajonale të Punësimit, përfaqësueses së Zyrës Arsimore Kamzë dhe përfaqësueses së Qendrës Kombëtare për Gratë Viktima të Dhunës në Familje. Gjatë diskutimeve të ndryshme u arrit në përfundimin se do të zhvillohen disa takime të ndryshme në muaj për dhunën në familje. Objekti i kësaj marrëveshjeje është koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të autoriteteve përgjegjëse në Bashkinë Kamzë për trajtimin e çështjeve të dhunës në familje, nëpërmjet riaktivizimit të mekanizmit referues. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përmirësimi i nivelit të sigurisë dhe sigurimi i mirëqenies për kategoritë e personave që janë viktimë të dhunës në familje, duke riaktivizuar sistemin e reagimit të koordinuar. Qendra të Drejtat e Njeriut në Demokraci në janar 2018 ka nisur zbatimin e projektit "Rritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve të Bashkisë Kamzë dhe Lezhë për gratë/vajzat e prekura nga të gjitha format e dhunës".

## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe fondacioni "Hanns Siedel", trajnim për taksën e ndërtesës në Bashkinë Kamzë

Në sallën e Këshillit Bashkiak të Kamzës, u zhvillua një trajnim në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me taksën e ndërtesës. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me fondacionin "Hanns Siedel" kanë ndërmarrë nismën për ofrimin e asistencës teknike për disa bashki në kuadrin e zbatimit të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa, bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 132, datë 7.3.2018. Asistenca është konceptuar si ngritje e kapaciteteve në vendin e punës dhe zhvillohet me punonjësit e Bashkisë, të Drejtorisë së Tarifave dhe Taksave Vendore dhe drejtorive të tjera. Kjo ofron mundësinë e diskutimit me ekspertë të fushës të problematikave specifike me të cilat hasen specialistët e tatimeve. Trajnimi u zhvillua nga ekspertët lokalë z. Ilir Sallaku nga Ministria e Financave dhe nga z. Agron Haxhimali drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë.



## Rruga "Halim Xhelo", një tjetër investim i rëndësishëm që u vjen në ndihmë qytetarëve të Paskuqanit

**Gjatë punimeve për ndërtimin e rrugës, 812 metra linearë të gjatë, ka qenë i pranishëm kryebashkiaku Xhelal Mziu**

Rruga "Halim Xhelo" është një tjetër investim i rëndësishëm që u vjen në ndihmë qytetarëve të Paskuqanit. Gjatë punimeve për ndërtimin e rrugës,

lidhjen e një zone, që është shumë e populluar, me lagjet e tjera të Paskuqanit, por edhe të zonave të tjera. Kjo rrugë ka një gjatësi prej 812 ml. Investimi

Kamëz për vitin 2018, ashtu si çdo vit tjetër, do të marrin jetë edhe dhjetëra projekte infrastrukturore në rrugë, kanalizime, si dhe në rikonstrukcionin dhe ndërtimin e objekteve shkollore dhe sportive. Mirëmenaxhimi i të ardhurave të Bashkisë ka bërë të mundur realizimin e këtyre investimeve, duke qenë se nga ana e qeverisë së majtë nuk ka pasur asnjë financim të projekteve jetike për qytetarët e Kamzës.



812 metra linearë të gjatë, ka qenë i pranishëm edhe kryebashkiaku Xhelal Mziu. Ai është takuar edhe me banorë të zonës, të cilët e kanë falënderuar kreun e Bashkisë për këtë investim me vlerë për ata dhe familjet e tyre. Kjo, për arsye se rruga "Halim Xhelo" shërben si një arterie lidhëse mes rrugës kryesore "Demokracia" dhe rrugës "Besim Çera", duke qenë kështu një investim mjaft i rëndësishëm për komunitetin e zonës. Rruga "Halim Xhelo" bën

i Bashkisë Kamëz në këtë rrugë ka një rëndësi të madhe sociale dhe ekonomike, pasi ndikon në lehtësimin e lëvizjes së këmbësorëve dhe të automjeteve. Gjithashtu, ky investim i jep një impuls pozitiv edhe zhvillimit të bizneseve, të cilat do të bëjnë të mundur hapjen e vendeve të reja të punës. Përpara ndërtimit të rrugës, Bashkia Kamëz pati ndërtuar edhe rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura. Me miratimin e buxhetit të Bashkisë

### Në Laknas një tjetër investim me rëndësi, ndërtimi i rrugëve "Konispol" dhe "Zef Llesh Doçi" me gjatësi 823 metra linearë

Në Laknas një tjetër investim me rëndësi do të realizojë Bashkia Kamëz në vitin 2018. Bëhet fjalë për ndërtimin e rrugëve "Konispol" dhe "Zef Llesh Doçi". Ndërtimi i këtyre rrugëve në këtë lagje ka një rëndësi të madhe si ekonomike e sociale, pasi ndikojnë në qarkullimin e lirë të automjeteve, si dhe në lehtësimin e lëvizjes së komunitetit të banorëve në atë zonë. Gjatësia totale e segmenteve rrugore ku do të investohet është 823 metra linearë. Gjerësia e rrugës e shtruar me



asfalt do të jetë 5,5 metra dhe gjerësia tërësore 6,5 m. Gjithashtu, pjesë e investimit do të jenë edhe kanalizimet e ujërave të bardha. Ndërtimi i këtyre dy rrugëve është në vazhden e projekteve të parashikuara në buxhetin 2018, një buxhet i pakrahasueshëm me njësitë e tjera vendore, por edhe buxheti më i madh i Bashkisë ndër vite. Ndërtimi i këtyre segmenteve përbën edhe një hap tjetër drejt zhvillimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të infrastrukturës urbane në qytetin e Kamzës, në çdo lagje që përfshin kjo Bashki.

### Në projektet e Bashkisë Kamëz për 2018-n, edhe rikonstrukcioni i shkollës "Tahir Sinani" në Kodër të Kuqe, Babrru

Në projektet e Bashkisë Kamëz për vitin 2018 është edhe rikonstrukcioni i shkollës "Tahir Sinani" në Kodër të Kuqe, Babrru. Bashkia Kamëz ka gati projektet për realizimin e dhjetëra projekteve të reja në territorin e saj në vitin 2018. Krahas ndërtimit të rrugëve dhe kanalizimeve, nga ana e Bashkisë do të ndërhyhet edhe në objektet shkollore. Një prej tyre është edhe shkolla "Tahir Sinani". Në fakt, për financimin e ndërtimit apo të rikonstrukcionit të shkollave dhe kopshteve të Kamzës është kërkuar mbështetja e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si ministri e linjës, por edhe ministrive të tjera. Kjo, pasi fondet për të realizuar këto investime janë të papërbalueshme nga Bashkia. Por nuk ka pasur asnjë reagim nga qeveria për asnjë projekt me të cilin ka aplikuar Bashkia Kamëz për pesë vite me radhë. Këto ndërhyrje në infrastrukturën arsimore janë emergjente, për shkak të nevojës së përmirësimit të kushteve të këtyre ambienteve. Bashkia i ka gati të gjitha projektet, si dhe ofron bashkëpunim edhe për garantimin e trojeve për të ndërtuar shkolla dhe kopshte të reja. Bashkia Kamëz



ka një mungesë totale të fondeve të akorduara nga ana e qeverisë për investime në institucione arsimore, por edhe në fusha të tjera po kaq të rëndësishme dhe jetike për qytetarët e Kamzës dhe të Paskuqanit. Duke parë këtë indiferencë të qeverisë, Bashkia, me të ardhurat e veta, ka planifikuar dhjetëra investime publike edhe në vitin 2018, ashtu si në vitet e mëparshme.

### Ndërtimi i kanalizimeve të rruga "Nazmi Rushiti" në lagjen nr. 4 Kamëz, një tjetër investim i Bashkisë në dobi të banorëve

Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura në rrugën "Nazmi Rushiti" në lagjen nr. 4 Kamëz është një tjetër investim i Bashkisë në dobi të banorëve të zonës. Segmenti ku do të ndërhyjë Bashkia Kamëz ka një gjatësi prej 220 metrash linearë, ku do të përdoren tuba me përmasa Ø 315. Ndërtimi i KUN në rrugën "Nazmi Rushiti" është parashikuar të realizohet në buxhetin e këtij viti dhe së shpejti pritet të nisim punimet. Ndërkohë që nga ana e qeverisë financimet e projekteve të ndryshme infrastrukturore për Kamzën janë zero, në buxhetin e Bashkisë janë parashikuar dhjetëra investime, të gjitha nga të ardhurat e veta. Duke parë shqetësimin e banorëve, nëpërmjet buxhetimit me pjesëmarrje është marrë parasysh edhe mendimi i komunitetit. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, është hartuar edhe projekti për



ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN) në rrugën "Nazmi Rushiti" në lagjen nr. 4 Kamëz.

### Bashkia Kamëz, e gatshme për të filluar investimet e planifikuara për vitin 2018

Bashkia Kamëz është e gatshme për të filluar investimet e planifikuara për vitin 2018. Me një urdhër të brendshëm të kryebashkiakut Xhelal Mziu, janë ngritur grupet e punës, të cilat kanë filluar me punën në terren për të bërë piktetimet e duhura për të krijuar terrenin e duhur për realizimin e rreth 80 investimeve të planifikuara për këtë vit. Ky angazhim i strukturave teknike të Bashkisë në sinkron të plotë me njëra-tjetrën si dhe në bashkëpunim me qytetarët është e gatshme për të filluar punën për realizimin me sukses të këtyre investimeve. Kryebashkiaku Mziu ka realizuar një mbledhje pune për të zbatuar me rigorozitet dhe brenda akteve ligjore sipërmarrjen e punës për të qenë transparent në këto projekte. Investimet e vitit 2018 janë pjesë e politikave të Bashkisë Kamëz për të zbatuar një strategji të përqendruar tek investimet dhe shërbimet. Të gjitha investimet që do të realizohen në territorin e Kamzës, janë planifikuar që të financohen pa përjashtim nga buxheti i Bashkisë. Janë 5 grupe të ngritura për të realizuar me sukses këtë sipërmarrje, ku përfshihen zona e Kamzës, Bathores dhe Paskuqanit. Kjo është puna e vazhdueshme që strukturat e bashkisë Kamëz realizojnë për ti shërbyer sa më mirë komuniteti i bashkisë Kamëz.



## Në çdo lagje, investime të Bashkisë; në vitin 2018 do të ndërtohen edhe kanalizimet në rrugën "Prezë", lagjja 4 Bathore

Në çdo lagje të qytetit do të ketë investime të Bashkisë Kamëz. Kështu, në vitin 2018 do të ndërtohen edhe kanalizimet në rrugën "Prezë", lagjja nr. 4 Bathore. Së shpejti do të fillojë të ndërtohet ky rrjet kanalizimesh, me përfundimin e procedurave përkatëse. Edhe ky investim i rëndësishëm për banorët e lagjes Bathore 4 do të financohet nga Bashkia, ashtu si edhe shumë projekte të tjera.

Ky projekt i Bashkisë Kamëz synon që të përmirësojë kushtet e jetesës së banorëve të zonës. Megjithatë ka një gjatësi prej 98 metrash linearë, zbatimi i projektit ndikon



pozitivisht te një numër i madh familjesh, pasi përbën një investim të rëndësishëm në kuadrin e ofritit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët. Me këtë angazhim, Bashkia, si institucioni që ka lidhje të drejtpërdrejta me qytetarët dhe problematikat e tyre, ka hartuar dhjetëra projekte.

Një ndër to është edhe ndërtimi i kanalizimeve në rrugët e Kamzës, të Bathores dhe të Paskuqanit. Ashtu siç ka ndodhur edhe vitet e mëparshme, investimet publike do të jenë kryefjala e punës së Bashkisë, e cila vetëm në këtë zonë ka bërë të mundur dhjetëra projekte me ndikim të jashtëzakonshëm social.

### Investimet e Bashkisë Kamëz në infrastrukturë, sukses i mirëpërdorimit të të ardhurave

Investimet e Bashkisë Kamëz në infrastrukturë gjatë viteve 2007-2018 përbëjnë një sukses të mirëpërdorimit të të ardhurave nga kjo njësi vendore. Kështu, në vitin 2017 u realizuan dhjetëra investime publike, fondi i të cilave ishte parashikuar në buxhetin e Bashkisë për këtë vit.



Në këtë buxhet, ashtu si në buxhetet e mëparshme, pjesa më e madhe e tij shkoi për investime, duke u përkthyer në realizime objektive të infrastrukturës rrugore dhe në ujësjellës-kanalizime.

Gjatë vitit 2017, sipas rregullores dhe ligjeve në fuqi, nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve u zbatuan të gjitha projektzbatimet dhe studimet e njëpasnjëshme të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e jetës dhe kushteve sociale të komunitetit të qytetit të Kamzës. Ndërkaq, edhe në vitin 2018 janë planifikuar dhjetëra investime të tjera në infrastrukturën rrugore, atë të kanalizimeve, në objekte arsimore, sportive etj.

Bashkia në vitin 2017 pati progres për sa u përket investimeve dhe shërbimeve ndaj qytetarit. Rol të rëndësishëm për këtë ka luajtur edhe mbledhja e të ardhurave nga tarifatat dhe taksat vendore, të cilat krahasuar me një vit më parë, ishin rreth 5% më shumë. Këto të ardhura janë përdorur për realizimin e investimeve publike dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Bashkia.

### Bashkia do të investojë këtë vit edhe për ndërtimin e zgjatimit të rrugës "Monarkia Shqiptare" në lagjen nr. 4 Kamëz



Bashkia do të investojë këtë vit edhe për ndërtimin e zgjatimit të rrugës "Monarkia Shqiptare" në lagjen nr. 4 Kamëz, me gjatësi 410 metra linearë. Me gjerësi rruge 6 m dhe gjerësi asfalti 5 m, ky segment rrugor do të lehtësojë kalimin e banorëve të zonës përgjatë tij, duke ofruar në të njëjtën kohë edhe një infrastrukturë të përmirësuar. Investimi në këtë rrugë është në vazhden e projekteve të parashikuara në buxhetin e vitit 2018, një buxhet i pakrahasueshëm me njësitë e tjera vendore, por edhe më i madhi ndër vite në

Bashkinë Kamëz. Ndërtimi i këtij segmenti përbën edhe një hap tjetër drejt zhvillimit të infrastrukturës në qytetin e Kamzës, në çdo lagje që përfshin kjo Bashki. Si institucioni që ka lidhje të drejtpërdrejta me qytetarët dhe problematikat e tyre, Bashkia ka hartuar dhjetëra projekte në fusha jetike.

Një ndër to është edhe ndërtimi i zgjatimit të rrugës "Monarkia Shqiptare" në lagjen nr. 4 Kamëz. Ashtu siç ka ndodhur edhe vitet e mëparshme, investimet publike do të jenë kryefjala e punës së Bashkisë, e cila vetëm në këtë zonë gjatë viteve të fundit ka realizuar dhjetëra projekte me ndikim të jashtëzakonshëm social. Të gjitha investimet janë financuar nga të ardhurat e vetë Bashkisë, pasi u bënë pesë vite që qeveria diskriminuese e Edi Ramës nuk akordon asnjë qindarkë për projekte emergjente për qytetin dhe qytetarët e Kamzës.

### Rruga e Zanave në lagjen 1 Bathore, me gjatësi 1480 metra linearë, tjetër investim themelor i Bashkisë Kamëz për vitin 2018



Rruga e Zanave në lagjen 1 Bathore, me gjatësi 1480 metra linearë dhe gjerësi 16 m, është një tjetër investim themelor i Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Ky investim do të realizohet nga fondet e Bashkisë ashtu si të gjitha investimet e tjera në pesë vitet e fundit. Kjo, për arsye se qeveria e majtë ka diskriminuar vazhdimisht Kamzën dhe qytetarët e saj, duke mos financuar asnjë projekt për ta. Rruga e Zanave do të ketë një infrastrukturë të ndërthurur me përmbajtje të të gjitha elementeve të nevojshme bashkëkohore. Kjo shihet edhe te komponentët e tillë si gjerësia 16 m, trotuarët në të dyja anët e rrugës me gjerësi 4 m, si dhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura. Përfitues të këtij investimi do të jenë jo vetëm qindra familje të lagjes Bathore 1, por edhe qytetarët e lagjeve të tjera të zonës, që kalojnë në këtë segment rrugor.

### Vazhdimi i rrugës "Londër" me gjatësi 330 metra linearë, investim i dobishëm për banorët e zonës



Vazhdimi i rrugës "Londër" me gjatësi 330 metra linearë do të jetë investim një i dobishëm për banorët e zonës. Projekti për ndërtimin e këtij segmenti rrugor bën pjesë në investimet e vitit 2018, që janë planifikuar të realizohen nga të ardhurat e buxhetit të këtij viti. Gjatësia e segmentit rrugor ku do të ndërhyjë Bashkia është 330 metra linearë, me gjerësi 5 m. Vlen për t'u theksuar se edhe ky investim do të realizohet tërësisht i financuar nga buxheti i Bashkisë, duke qenë se qeveria e varfërisë, qeveria e Edi Ramës, nuk financon asnjë projekt të Bashkisë Kamëz, edhe pse nevojat e qytetarëve janë shumë të mëdha dhe projektet e gatshme, të hartuara sipas standardeve bashkëkohore. Megjithatë, Bashkia Kamëz ka zgjedhur të qëndrojë pranë qytetarëve të saj, si me investime ashtu edhe me shërbime cilësore e korrekte për ta.



## Bashkëpunimi i Bashkisë me BKT, shtohet numri i pemëve të mbjella në qytetin e Kamzës

**Kontributi për mjedisin, BKT bën të mundur mbjelljen e 40 pemëve dekorative në rrugën “Bujar Lako” në Zall-Mner**



Vijon bashkëpunimi i Bashkisë Kamzë me institucione të ndryshme, në dobi të mjedisit të qytetit. Kështu, kryetari i Bashkisë, z. Xhelal Mziu, dhe drejtori i Grupit të Bankingut Individual në Bankën Kombëtare Tregtare, z. Fatih Karli, mbollën 40 pemë përgjatë rrugës “Bujar Lako” në Zall-Mner. Mbjellja e pemëve në këtë rrugë u bë e mundur nga Banka Kombëtare Tregtare si pjesë e kontributit në kuadër të nismës së Bashkisë “Jepi jetë Kamzës – dhuro një pemë”.

Kryebashkiaku Mziu e priti z. Fatih Karli edhe në ambientet e zyrës në Bashki. Gjatë takimit biseda mes tyre u përqendrua në bashkëpunimin mes dy institucioneve, fryt i të cilit ishte kontributi i mbjelljes së pemëve në rrugën “Bujar Lako”. Gjithashtu, gjatë takimit z. Mziu e njohu drejtorin e Grupit të Bankingut Individual në BKT me zhvillimet në

qytetin dhe Bashkinë e Kamzës. Z. Mziu theksoi si avantazhe të Kamzës pozicionin gjeografik, moshën e re të popullsisë, si dhe politikën fiskale të Bashkisë, të cilat favorizojnë biznesin në këtë qytet.

Në këtë aspekt, kreu i Bashkisë pohoi se jo vetëm kompani shqiptare, por edhe ato të huaja zgjedhin që të sjellin aktivitetin e tyre në qytetin e Kamzës. Investimi në drejtim të mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit është një nga vizionet e zhvillimit progresiv të Bashkisë së Kamzës.

ntensiteti i mbjelljes së pemëve dekorative është rritur duke përfutur kohën me favorizimin e saj, që lejon vazhdimin e këtij procesi. Përmirësimi i ambientit dhe mjedisit në tërësi për qytetin e Kamzës është një objektivi i arritur tashmë dhe një prej qëllimeve të vëna për mbrojtjen e vazhdueshme të

jetës njerëzore, banorë dhe vizitorë në qytetin e Kamzës. Për këtë qëllim, me nismë të kryebashkiakut Xhelal Mziu janë angazhuar të gjitha strukturat e Bashkisë Kamzë dhe ndërmarrjet në varësi për të realizuar objektivat e caktuar qysh në fillim vitit, duke tejkaluar çdo parametër të planifikuar. Kësaj nisme i janë bashkuar edhe qytetarë dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Kamzë, siç është edhe rasti i Bankës Kombëtare Tregtare.

Ndryshimi i qytetit me investime themelore të kryera në infrastrukturë, ujësjellës e kanalizime shkon paralelisht në harmoni edhe me investimin në fushën e mjedisit. Kryebashkiaku Mziu ka theksuar se do të operohet në çdo shërbim, por veçanërisht në ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit në Kamzë.

## Mbyllet sezoni i mbjelljeve në Bashkinë Kamzë me një numër prej 121 mijë e 423 pemësh

Bashkia Kamzë mbyll sezonin e mbjelljeve të pemëve dekorative, duke kapur shifrën e 121 mijë e 423 pemëve.



Kjo shifër është pjesë e projekteve që ka pasur institucioni për periudhën e parë të mbjelljeve të pemëve. Kryebashkiaku Xhelal Mziu në vizionin e tij qysh në fillim të sezonit për mbjelljet ka pasur synimin që strukturat e të gjithë administratës të jenë të angazhuara për përmbjelljen me sukses të këtij aksioni. Investimi në drejtim të mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit ka qenë një nga vizionet e zhvillimit progresiv të qytetit të Kamzës që nga viti 2007 e deri tani. Përmirësimi i ambientit dhe mjedisit në tërësi për qytetin e Kamzës është një objektivi i arritur, falë edhe kontributit të qytetarëve, bizneseve, kompanive, shoqatave dhe organizatave të ndryshme. Të gjithë së bashku kanë kontribuar për përmirësimin e mjedisit në kuadër të nismës së Bashkisë “Jepi jetë Kamzës – Dhuro një pemë”. Nga dita në ditë ky qytet njih zhvillim në drejtime të ndryshme, duke u shndërruar kështu në një qytet tërheqës, si për banorët, vizitorët, bizneset etj.

## Kaldaja te kopshti “Kamza e Re”, bashkëpunim i ngushtë Bashkisë Kamzë me pedagogët e Universitetit Bujqësor



kryebashkiaku Xhelal Mziu i shoqëruar nga përfaqësues të institucionit të Bashkisë dhe nga ana e Universitetit Bujqësor morën pjesë në këtë ceremoni dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit njëkohësisht dhe koordinator i projektit “COMPOSE”, prof. dr. Fatbardh Sallaku, si dhe përgjegjësjat dhe edukatore të kopshtit “Kamza e Re”.

Një bashkëpunim i ngushtë institucional i Bashkisë Kamzë me pedagogët e Universitetit Bujqësor Tiranë bëri të mundur vendosjen e një kaldaje ngrohjeje për fëmijët e kopshtit “Kamza e Re”. Ky fryt bashkëpunimi u finalizua në kuadrin e zbatimit të projektit “COMPOSE” në rritjen e efikasitetit energjetik dhe zhvillimin e komuniteteve lokale. Në këtë përrurim ishte i pranishëm

Funksionimi i kaldajës e ka dhënë ndikimin e saj në ngrohjen e mjediseve ku fëmijët edukohen në këtë institucion parashkollor. “Kjo nismë është fryti i parë i këtij bashkëpunimi ku palët premtuan që dritarja e hapur është udhëtimi i gjatë i zbatimit dhe projekteve të tjera ndërinstitucionale për të rritur kapacitetet e investimeve”, - tha ndër të tjera në fjalën e tij përshëndetëse kryetari i Bashkisë, z. Xhelal Mziu.

## Biznesi i vogël në Kamzë në protestë kundër skemës së TVSH-së

Në Kamzë është protestuar kundër skemës së TVSH-së të qeverisë qendrore, e cila nga data 1 prill 2018, implementoi këtë skemë në masën 20% për bizneset e vogla. Implementimi i kësaj skeme sigurisht është një tjetër reformë dashakeqëse që paaftësia e saj po lind çdo ditë e më tepër pasigurinë për jetën, mbylljen e mijëra vendeve të punës nëpërmjet politikave frenuese dhe denigruese për të gjitha familjet që punësimin e tyre e kanë zanafillën tek këto biznese. Në Bashkinë Kamzë janë futur në skemën e TVSH-së 520 biznese të vogla nga 2520 total që janë regjistruar në këtë



Bashki, nga të cilat, shprehur ndryshe, rreth 21% të totalit të tyre janë pjesë e skemës së përfshirjes në TVSH-në e cituar. Falimenti është më se i qartë dhe jo vetëm kaq, por një rrezik serioz për mbarë qytetarët e Kamzës, të cilët do të jenë bartës të një tarife çmimesh 20% më të larta për çdo artikull konsumi duke favorizuar qeverinë “Rama” për të financuar koncesionarët dhe oligarkët e tij. Protesta shënoi një reagim që bizneset dhe qytetarët e Kamzës do të jenë në kundërshtitë të çdo veprimi arbitrar të vendimeve absurde të kësaj qeverisje qendrore.